



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 46

Datë: 12. 09. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2.Aktivitetet e SKQZ-së

3.Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për de certifikim të kandidatëve me Aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës

4. Të ndryshme

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 46 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në të cilën mbledhje të radhës do të kemi dy pika të rendit të ditës. Aktivitetet e Sekretariatit dhe aktivitetet e zyrës për regjistrim të partive politike faktikisht vazhdimi mbledhjes të djeshme në këtë pikë. Para fillimit unë kisha dashur të ju njoftoj që sot edhe zyrtarisht zoti Nenad Rikalo i cili deri më sot ka qenë anëtarë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka dhënë edhe zyrtarisht dorëheqje për çka edhe më ka njoftuar dhe njëkohësisht e ka njoftuar edhe zyrën e Presidentit dhe se në ndërkohë do të kemi edhe zëvendësimin e tij nga subjekti përkatës politik. Gjithashtu kisha dashur të ju njoftoj edhe opinionin se edhe dje i kemi

marr të gjitha rekomandimet e misionit vëzhgues të Bashkimit Evropian ku edhe zyrtarisht na është dorëzuar dokumentacioni dhe rekomandimet të cilat ne do ti implementojm edhe për zgjedhjet lokale dhe se ky mision që nga sot edhe zyrtarisht e ka filluar misionin dhe vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve. Këtu desha vetëm të bëjë disa njoftime para fillimit dhe para miratimit të këtij rendi të ditës.

Meqenëse tashmë e keni rendin e ditës para jush, kush është për këtë rend dite? Në qoftë se ka dikush vërejtje? Kush është kundër? A ka abstenime? Ok, me një abstenim. Faleminderit.

Vazhdojmë me aktivitetet e Sekretariatit. Urdhëro drejtoreshë...

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP – it: Përshëndetje të nderuar anëtarë të KQZ-së, jeni të informuar me aktivitete e Sekretariatit të cilat aktivitete janë zhvilluar për zgjedhjet lokale prej 30 gushtit, deri me 12 shtator. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar aktivitete komfor planit operacional të shërbimit të votuesve, kështu që nga divizioni i shërbimit të votuesve për të gjithë aplikuesit të cilët gjatë periudhës të aplikimit nuk i kanë plotësuar kushtet për regjistrim i kanë njoftuar përmes e-mail dhe përmes telefonit ku edhe janë kërkuar dokumente plotësuese për regjistrim të tyre. Numri i aplikuesve të cilët janë refuzuar për gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim për votim për mes postës është 1338 ku të gjithëve ju janë dërguar statute të njoftimit për të drejtën e ankesës. Gjithashtu votuesit jashtë Kosovës kanë pasur edhe mundësi që të sfidojnë listën votuese jashtë Kosovës që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-ës. Gjithashtu për periudhën e shërbimit të votuesve, për nderimin e qendrave të votimit dhe për periudhën e konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve është aktivitet që është zhvilluar prej periudhës kur ka filluar aktiviteti. Periudha e shërbimit të votuesve për ndërrim e qendrës së votimit përfundon sot pra me 12 shtator dhe për gjatë kësaj periudhe ndërrim të qendrave të votimeve kanë kërkuar rreth 4 mijë votues të cilët kryesisht numri i tyre ka ardhur përmes aplikacioneve online.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, tha znj. Meha, do të hartohet edhe një raport i detajuar për numrin e kërkesave të pranuar për ndërrimin e qendrave të votimit dhe për numrin e kërkesave të aprovuara të qendrave të votimit. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar edhe procesi i trajnimit dhe hartimit të dokumenteve, është hartuar drafti i doracakut te procedurave të votimit dhe të numërimit për zgjedhjet lokale i cili pritet që brenda javës së ardhshme të silltet në KQZ-ë dhe të aprovohet. Ndërkaq në aspektin logjistik ka vazhduar hartimi i specifikave për materiale zgjedhore dhe për materiale administrative të cilat janë paraparë për zgjedhjet lokale. Për sa i përket personelit ka vazhduar hartimi i dokumenteve, kontrata për personelin të cilin e kemi të angazhuar në këtë periudhë të parakohshme që janë për zgjedhjet lokale, gjithashtu edhe sektorët e tjera divizionet e tjera janë zhvilluar aktivitetet në bazë të procedurave që janë si mjete të zotimit të mjeteve të shpenzimit dhe të mjeteve tjera d.m.th. ky raport e përfshin periudhën prej 30 gushtit deri me 12 shtator.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje? Po, urdhëro Adnan.

Adnan Rrustemi: Faleminderit drejtoreshës për njoftimin. Natyrisht që çdo ditë e më tepër, po përfshihemi në mënyrë më intensive në aktivitete në përgatitje. Unë, megjithatë i kam disa pyetje dhe disa kërkesa, ndoshta drejtoresha nuk mundet sot të përgjigjet por, mundet me na përcjell si materiale. Në radhë të parë po më intereson për vizitat në makinën kërkuese të votuesve për tu njoftuar për vendvotimin e tyre qendrën e votimit. E kuptoj që në këtë mbledhje ndoshta e ka të pamundur por, si informacion është relevant për ne me pa se cili është qasja e qytetarëve. E dyta sa i përket votuesve jashtë vendit kamë një kërkesë që ndoshta e ka planifikuar shërbimi votues por, për shkak të ekonomizimit të kohës do të thosha edhe përfshirjes sa më të madhe të këtyre që janë regjistruar në votim, të ju dërgohen edhe në mënyrë elektronike materialet, njoftimet, fletëvotimi elektronik i cili publikohet edhe në ueb faqe sikurse edhe listat e kandidatëve të zonës ose të komunës përkatëse që mos të presin d.m.th. dërgimin fizik të plikove dhe të materialeve fizike nga ana e KQZ-ës të cilët mund të mbërrijnë me vonesë e mund ta bëjnë të vështirë kthimin me kohë pastaj. E treta, sa i përket sfidimit periudhës së sfidimit po më intereson a ka pasur ndonjë rast që është sfiduar në këtë periudhë, ndonjë kërkesë që është larguar nga lista e votuesve nëpërmjet procesit gjyqësor. E para fundit e kamë marr si informacion që sekretariati ka dërguar një listë të komisionarëve subjekteve politike, KKZ-ve të cilët nuk mund të angazhohen në proces zgjedhor, si përshtypje e kam që i jeni referuar kutive nga rinumërimi por, personalisht nuk e kam këtë informacion kam bindjen që as anëtarët tjerë. Është mirë ma na dërguar këtë listë edhe me ditë kush janë edhe me ditë arsyet pse nuk mundën me kanë edhe për me pas ne përgjigjet por, edhe me pa eventualisht mos është bërë ndonjë gabim sepse nuk ka kaluar përmes trupave të KQZ-ës në këtë rast dhe në fund e kam një shqetësim që lidhet me informimin e votuesve që është e vërteta.

Unë, tha z. Rrustemi, i kuptoj këto shpjegimet që po na jepen për, vështirësitë në procedura, ankesat në autoritetin e prokurimit, ri tenderimin e tjerë por, shumë periudha kaluan e tash po hymë në periudha tjera që thua se është shumë i domosdoshëm, i domosdoshëm ka qenë edhe në periudhat e mëparshme por, sidomos tash për fazën e si të plotësohet fletëvotimi, për mënyrën e votimit ne nuk duhet të vonohemi në asnjë mënyrë. Nuk po e shoh në këtë njoftimin këtu që sërish ka ankesa dhe po e shpreh si shqetësim nuk është që po kërkoj as përgjigje as zgjidhje por, jam i shqetësuar që është e vërteta për pengesat që po na dalin në këtë aspekt dhe përballjen që mundemi me pas me numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme sërish ani pse ka qenë si zotimi i jonë dhe një lloj adresimi i jonë që më u angazhu mu ul kategori të fletëvotimeve.

Betim Gjoshi: Faleminderit për fjalën. Unë dëshiroj me falënderuar Sekretariatit që kërkesës që kemi pasur dje që e kam parashtruar unë dhe e keni mbështetur të gjithë për me na sjell informata për aktivitete të Komisionit Qendror Zgjedhor në lidhje me përgatitjet për zgjedhje por, edhe për mbarëvajtjen në përgjithësi të punëve u janë përgjigj pozitivisht. Mua më gëzoj fakti që të paktën për nja tri çështje që i pashë në këtë raport edhe po d'u me ju përgëzuar, e para është për mu edhe për institucionin tone shumë më të rëndësi dy projektet të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës të Komisionit Qendror Zgjedhor, por edhe rritjen edhe efikasitetin e punës është modernizimi që ka të bëjë me identifikimin e materialit zgjedhor projekt i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe pe shoh që janë bërë përgatitjet për me filluar është edhe skanimi elektronik i formularëve të rezultateve pilot projekt që kem filluar ne zgjedhjet e kaluara që tashme qenka bërë projekt me kohë jo herën e kaluara

qysh e kemi bo shumë dita para zgjedhjeve edhe na ka ndihmuar IFES, kjo mendoj që ndërlidhet me rekomandimet e bashkimit evropian ku kanë kërkuar që na me vazhduar më tutje me skanimin e formularëve dhe ndikon pozitivisht edhe e treta është ri dizajnimi që po ja bënë ueb faqes të Komisionit Qendror Zgjedhor edhe ky është projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe ueb faqja jonë ka pasur nevojë për ri dizajnim. Çka kisha kërkuar është ju e dini që edhe kur e kemi bërë projektin ju ka kërkuar që personave të cilët janë palë duhet të jenë të ftuar edhe duhet të jenë pjesëmarrës në Komisionin Qendror Zgjedhor përfshirë edhe media dhe shoqërinë civile, është mirë të ja bënë që ueb faqja në mënyrë automatike me i njoftuar për mbledhjet edhe takimet të Komisionit Qendror Zgjedhor. Kjo ndihmon që edhe neve ta heqim obligimin se kush është presoni përgjegjës mi njoftuar. Edhe e dyta na bënë që ne ta rrisim transparencës karshi vendimmarrjes edhe punës tonë. Pra, kjo de të jetë një adresim automatik ashtu siç e kanë edhe shumë institucione tjera, mundësi teknike ka kanë thënë edhe herën e kaluar, kështu që kisha kërkuar me pas kujdes gjatë implementimit të projektit për ri dizajnim të ueb faqes me parapa edhe këtë mundësi edhe mundësin normal me u shfaq mbledhjet e Komisionit Qendror Zgjedhor live. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit Betim. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, urdhëro Sami...

Sami Hamiti: Te plani i prokurimit, te implementimi, e keni shkruar plani i prokurimit...! Ku është plani që e implementoni i projektit...? Ku i keni procedurat tjera, një kërkesë që ka rrjedh nga Komisioni Qendror Zgjedhor...! Drejtoresh, t'i je këtu po e zëvendëson krye shefin, pavarësisht a jemi në proces të zgjedhjeve..., afatet ligjore duhet të jenë me kohë. Kërkesa ka qenë shumë më herët që të bëhet një raport i punës sepse, kërkesa ka qenë të jetë edhe raporti i shpenzimeve...Raportin e punës, nuk e keni sjellë, nuk e ka sjell krye shefi... Po flas për menaxhmentin, dhe kur ta bëni implementimin e qitni edhe planin: çka është realizuar e çka jo, jo vetëm çka është realizuar ose çka është në procedurë se, ka afate të cilat i keni në plan të prokurimit dhe të cilat nuk janë nisur me kohë edhe nuk janë të pasqyruara këtu...

Valdete Daka: Me siguri që drejtoresha për mbledhjen e ardhshme, do të na i përgatitë përgjigjet të cilat u bënë sot, se e dimë që me siguri nuk mundet në këtë moment me na i dhënë të gjitha përgjigjet. Nëse nuk kemi edhe diçka tjetër vazhdojmë me aktivitetet e zyrës faktikisht vazhdojmë aty ku kemi mbetur dje, e ajo është shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për de certifikimin i kandidatëve me aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Unë vetëm një pyetje e kisha pas për drejtoreshën, a ka ndrru diçka në ndërkohë, edhe mos kemi ndonjë evidentim të ndonjë gabimi eventual apo, përmirësim apo ndryshim të asaj listës të cilën e kemi pas dje...?

3. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për de certifikim të kandidatëve me Aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare. Zyra dje kur e ka dërguar rekomandimin, rekomandimi mbetet i njëjtë, nuk ka ndonjë ndryshim edhe pse i kemi hulumtu do të thotë edhe një herë i kemi ri shikuar të

gjitha ato të dhënë që na janë dorëzuar nga gjykata nuk ka ndonjë ndryshim. Ju i keni do të thotë të gjitha ato shënime ose të dhënat e rekomandimit që e ka dhënë zyra dje. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoresh. A ka dikush tjetër diçka me shtuar përveç atyre që i kemi thënë dje, ato të gjitha që janë fol dje që janë diskutuar mbesin por, a ka dikush edhe diçka tjetër shtuar? Urdhëro Eshref.

Eshref Vishi: Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtarë, unë personalisht jam pran konstatimit dhe qëndrimeve nga mbledhjet e kaluara ku kjo temë u trajtuar me disa herë e që ky vendim ndërlidhet me nenin 29 të ligjit të përgjithshme për zgjedhjet e përgjithshme që konsideroj që është në kundërshtim me të drejtat themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë. Po ashtu ky përkufizim i ligjit ky paragraf konsideroj se është jashtë standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve aplikative të brendshme që trajtojnë vepra penale, konkretisht me kodin penal të Kosovës, ku disa vepra nuk kanë pasoja juridike për të dënuarit sidomos dënimet me gjobë, që shumica e gjykimeve që kanë arrit nga gjyqësori i Kosovës janë të tilla, dhe deklaroj votën time që jam kundër, që thjesht me vendim të KQZ-së t'i merret dikujt një e drejtë kushtetuese.

Valdete Daka: Faleminderit Eshref, nëse nuk kemi diçka tjetër, po urdhëro.

Adnan Rrustemi: Është e vërtet që në mbledhjen e ndjeshme, si të themi e kemi konsumuar mendimet dhe pikëpamjet dhe argumentet nuk ka asnjë dyshim që ne nuk do të angazhohemi që listat zgjedhore të jenë sa më kredibile gjithmonë në përputhjen me kushtetutën dhe ligjet e tjera, por ashtu qysh unë jam i bindur që në listën e cila na u ka prezantuar, ka shumë raste të cilët e meritojnë ose shumica që të de certifikohen dhe të largohen nga lista dhe unë jam për d.m.th. që të largohen nga lista gjithë ata që siç e kam thënë dje e kanë keqpërdorur detyrën zyrtare janë dënuar për korrupsion dhe janë dënuar për krime të rënda, kanë vuajtur burg në mënyrë efektive por, në anën tjetër edhe duke u nisur nga ajo që neni i ligjit bie në kundërshtim me nenin 45 të kushtetutës dhe disa nene të kodit penal ku flet për pasojat juridike të disa dënimeve të thjeshta, unë po ashtu ndaj bindjen që në mesin e kësaj liste ka shumë raste të cilët po penalizohen në një farë mënyre për disa veprime që më shumë burojnë nga pakujdesia se sa veprimi i qëllimshëm siç janë aksidentet në komunikacion edhe për me qartësuar unë jam pa i dit shifrat se cilit subjekt politik ose sa janë të tilla e tjerë e tjerë, se nuk e kemi pasur atë kategorizim që e kemi kërkuar.

Unë, tha z. Rrustemi, kam thjesht qëndrimin parimor dhe profesional aspak politik nuk ka të bëjë me asnjë kandidat në veçanti dhe me asnjë subjekt politik por, mendoj që ne është dashur me bo një lloj kategorizimi që rastet e tilla të cilët janë dënuar për shkak të komunikacionit e që kanë qenë dënime me gjoba të ulëta mos ti largojmë nga lista ndërkohë që tjerët padyshim që ti largojnë nga lista të gjithë ata që janë dënuar dhe në përputhje me kodin penal. Si të tillë d.m.th. me qenë se nuk na ka ardhur një listë e tillë unë kam kërkuar që ti kemi një për një rastet dhe jo listën e përgjithshme d.m.th. ku nuk i bëjmë bashkë të gjithë d.m.th. edhe ata që vërtetë e meritojnë që të de certifikohen me ata që personalisht mendoj që nuk e meritojnë që të de certifikohen.

Betim Gjoshi: Faleminderit kryetare, së pari edhe kjo që po e diskutojmë e dëshmon që Kosova duhet ta

ketë një reformë ligjore në fushën e zgjedhjeve. Ligji që e kem para vetës është jashtëzakonisht arbitrar edhe unë pajtona me kolegët e mi me këtë pjesë, i barazon edhe i fut me n'i thes me të gjithë pa marr parasysh se me çfarë dënime dhe me çfarë veprash penale kanë të bëjnë, këta që po i de certifikojmë sot është mirë që mos të ja bëjmë me gjyq të dytë, pra këta janë qytetar të Kosovës, kanë të drejtë të garojnë në zgjedhjet e kaluara, një pjesë e madhe prej tyre kanë mujt me pas fatkeqësi komunikacioni dhe ka ardhë deri të rasti që ata sot duhet të i de certifikojmë ne...Pra, këtë e kërkon ligji prej zgjedhjeve dhe vendimet e gjykatës në formë penale edhe unë pajtona plotësisht që ligji është i padrejtë edhe në qoftse kuvendi i Kosovës miraton një ligj, do të jetë ligji i parë, ligji për zgjedhjet i cili ai do ta ndryshojë këtë edhe e ka deklaruar që një kohë të gjatë, besoj që krejt këto zgjedhje na kanë dëshmuar që ky ligj ka jashtëzakonisht të meta. Pra, sot jemi para një rrugë që ne ta respektojmë një ligj që të kem në fuqi pa marr parasysh se sa është i drejtë edhe sa është i padrejtë, mua më vjen keq që ne sot duhet të i de certifikojmë personat që kanë pas aksidente trafiku ose që janë dënuar me gjobë, kandidatët e subjektit tim të cilët kanë shpreh gatishmëri në emër të subjektit që më kanë nominuar e janë të gatshëm me marr vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor të gjithë janë dënuar me gjobë, 90% të tyre kanë për vepra penale komunikacioni apo të ngjashme.

Janë dënime të lehta që nuk është dashtë të ju merret kjo e drejtë, tha z. Gjoshi dhe shtoi më tej: ligji është i tillë, qysh thash edhe ma herët pra ligji është arbitrar edhe neve na ka ra hise edhe kësaj here ta zbatojmë me a pa dëshirën tonë. Unë mendoj që ne sot, duke pas parasysh të drejtat e njeriut edhe duhet me u mundu me i mbrojt këta njerëz që këta mos të izoloohen në shoqërinë e tyre edhe mos ta marrin ata që mos të jen ata njerëz që mos ta kenë bërë atë farë dëmi, unë sot pata një mjeke që kish pas ba aksident, ishte një punëtorë e zellshme, edhe kish pas aksident trafiku ku si rezultat i pakujdesisë nëautomjetin tjetër që ka pas aksident, ka pas një të lënduar edhe si rezultat i saj pa marr parasysh fajsin e saj, ajo është dënuar me gjobë 100euro, pra ajo mund të jetë një mjeke e mirë, por mund të jetë nesër edhe një deputete e mirë edhe një asambliste e mirë po e ka rastis kjo, pra ky është përshkrimi i përgjithshëm i këtyre ka në mesin e tyre siç thanë kolegët edhe personat për vepra ma të rënda d.m.th e dinë secili për subjektin e vet, na çka duhet me bo sot është e para sido që të jetë vendimi duhet me ju jep të drejtë 24 orë që me Komision Qendror Zgjedhor që kanë naj fakt që këto aktgjykime nuk janë të formës së prerë apo i kanë liruar me pru argumente. E dyta duhet me ju dhanë subjekteve politike se na duhet me kuptuar që po i tërheqim me vonesë si rezultat që i kem marrë këto vendime me vonesë prej shtetit gjyqësor e me ju dhanë një mundësi që të i zëvendësojnë këto të paktën ditën e premte, për arsye se I duhen, kanë organe vendimmarrëse brenda subjekteve politike e kjo nuk e pengon aspak na e kem vendos shortin, këta persona d.m.th e vendosin numrat e tyre që e kanë, nuk e pengon asgjë procesin zgjedhor nëse dikush ka nndonjë mendim tjetër nga sekretariati apo zyra po është mirë me na tregu nëse sjell ndonjë problem në asnjë mënyrë nuk jam për me rreziku procesin zgjedhor pra këto mendoj janë dy që në një far mënyre i garantojnë që ata të mos dëmtohen edhe e fundit është që vendimet duhen të jenë individuale po në secilin rast ju duhet që ta shënoni një vendim ku komfor neni 29.4 ku ne e kem të drejtën me i de certifikuar pas certifikimit të kandidatëve edhe komfor neni 29 pikën Q me ja u shënuar vendimet që ata janë të bazur në aktgjykim të gjykatës që na duhet me marr këta proces edhe dje ju kam than domethënë ju kam kërkuar me shty mbledhjen për me mbërriri te një vendim konsenzual po më vjen keq edhe sot edhe mbas kësaj kohe nuk kemi arritur te konsensusi, do të ishte mirë sepse këto vendimet që janë pak më të vështira me konsensus. Sepse thash këto procesverbale në rendin e ditës i miratojmë lehtë, por për këto të vështirat mendoj që sot ka pasur gatishmëri për një debat pak më të gjerë me biseduar nuk kemi pasur ndonjë hapësirë ligjore mi klasifikuar se do të ishte dëshira më madhe për ti klasifikuar se do ti binde edhe subjektin politik timin që

asnjë rast mos ti hiqej. Por kjo është ligji edhe sot i keq i mirë, mendoj që jemi para një akti të kryer që ne do ta zbatojmë, faleminderit.

Valdete Daka: Urdhëro Sami....

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Betimi e tha një shumicë të asaj që edhe unë desha ta them, që është e vërteta edhe kërkesat e mija që kanë qenë më të hershme po dalin të jenë të sakta në kuptimin e asaj që kam kërkuar të bëhet një verifikim i plotë sepse bazë shkresave paraprake kemi parë që ka pasur shkarje dhe mos përputhje të këtyre kandidatëve në listë që ka qenë. Po flas për subjekte që kanë qenë 12 tash janë 9 sepse kërkesat janë ka qenë komplet e 2014 d.m.th tre vetë kanë dalë që kanë qenë të pa afatshëm dhe pas rishikimit janë hequr prej liste po ashtu unë kam vërejtje në zyrë që dje në kohën sa kemi qenë brenda në Komisionin Qendror Zgjedhor na është lëshuar shkresa prej këshillit gjyqësor unë kam pasur hezitime dhe dyshime që nuk janë trajtuar të gjithë kandidatët. Tani e kemi një shkresë nga këshilli gjyqësor që numri 1 e deri 7.300 e sa janë verifikuar të gjithë, ishalla janë verifikuar unë nuk besoj por ata e kanë marrë atë përgjegjësi.

Në anën tjetër, tha z. Hamiti, sa është e drejt në kuptimin e asaj që po themi të klasifikohen apo të kualifikohen nuk na është dhënë ajo e drejt dhe kam marrë interpretime që ne nuk jemi ata që i klasifikojmë veprat në kuptimin sepse është qesharake që po ashtu që 9 kandidatët që largohen nga subjekti im janë për gjoba asnjë nuk ka dënim efektiv, por tash relacioni ka ardhur te ky edhe anën tjetër një perceptcion tjetër që është krijuar ditëve të fundit që janë barazuar anëtarët e KQZ-së, thjesht me thënë si kriminel që nuk po i de certifikojmë hezitimi janë ka qenë thjesht sepse ligji, neni i ligjit i cili është qe arbitrar që ja mohon të drejtën për një vepër aq të vogël që unë kam listë që nuk është dënuar fare, ka vërejtje veç procedura gjyqësore 40 euro dënim dhe largohet sepse thotë do të dënohet herën tjetër por thotë konsumimi i veprës penale ka ekzistuar dhe është në listë, tash më atë logjik po themi që është dashur këtu më shtyri edhe Betimi në këtë pjesën tjetër që tha se çka do që të ndodh PDK-ja do ti largon nga lista kjo i bënë që atëherë subjekti jem është një subjekt që nuk do ti largoj të krijohet edhe një perceptcion tjetër. Edhe e treta, kryesorja po e presim të certifikohet një kandidat i ri edhe e di që me atë kandidat kalohet prandaj unë do të jem për.

Illir Gashi: Në fakt para dy dilemave, një dilemë morale dhe ligjore unë do të diskutoj pak për këtë dilemën morale të cilën pak a shumë e thanë sepse dilemë ligjore nuk kam. Është shumë e pa drejt, pajtohem që rastet që i kemi të paraqitura nuk janë të njëjta dhe për fatkeqësinë e tyre barazohen veprat me rastin konkret por ligji e ka pamundësuar që ne të bëjmë klasifikimin dhe këtë dilemë duhet t`ju largojmë gjithë këtyre që sot eventualisht do të largohen do të de certifikohen. Nuk ka dhe s`ka pasur asnjë mundësi ligjore që ne të bëjmë klasifikime të tilla se kush ka mundur të hiqet ose kush ka mundur të mbetet, për faktin se ligji nuk e ka krijuar një mundësi të tillë.

Ndoshta, tha Gashi, nuk kishte me qenë mirë edhe me ngre dilema të tilla ligjore e thanë kolegët që ne parapakisht javën e kaluar është fakt që nuk jemi pajtuar për faktin se nuk e kemi pasur lëndën e kompletuar se vetëm atëherë dje kur ka ardhur shkresa nga këshilli gjyqësor ne e kemi parë që lënda është kompletuar dhe duke u bazuar në ligjin mbi zgjedhjet i cili për neve është edhe kushtetutë. Konsideroj që janë përmbushur gjitha obligimet tona ligjore, edhe unë gjithashtu do të jem pro de certifikimit të këtyre kandidatëve si pasoj e vendimit bazuar në ligjin mbi zgjedhjet, faleminderit.

Binak Vishaj: Kur kemi bërë kërkesën për me i verifikuar emrat krejt KQZ-ja komplet e ka përkrahur atë këtë kërkesë që ta aplikojmë një standard ligjor edhe nuk kemi pasur problem me kërkesën, kemi pasur problem me gjithë përfshirjen dhe me saktësi këto dy elemente besoj tash dy dilema na u kanë larguar pasi që dje këshilli gjyqësor ka sjell një shkresë që këta janë emrat në 3 vjetët e fundit ekziston gjykim i formës së prerë me gjithë dilemat e mija për ligjin cilin unë mendoj që nuk është në harmoni me kushtetutën në vend dhe me kodin penal si e drejta themelore si pjesa e pasojave juridike unë do të jem për duke dashur me respektuar ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, sepse e kemi obligim si institucion ta respektojmë dhe të punojmë me këtë ligj.

Valdete Daka: Faleminderit Binak, nëse nuk ka askush diçka me shtuar.

Betim Gjoshi: Kryetare edhe njëherë e kisha një lutje për gjithë kolegët që me qenë unik në vendim marrje pa marrë parasysh ato që janë debatuar. Edhe e dyta mendoj që na, ky standard unë si kesh si nuk kesh anëtar i KQZ-së është mirë nëse është ligji i njëjtë me vlejte edhe për zgjedhje nacionale edhe për zgjedhje të jashtë zakonshme që mos ti bie që na po i hymë në hak disa njerëzve që kandidojnë për disa poste më të lehta siç janë asamblistë e po i lëmë personat tjerë që garojnë për pozita tjera. Duhet ta vumë një standard për të gjithë, faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit, shpresoj që në zgjedhjet parlamentare që ta kemi këtë ligj të zbatohet ky standard përsëri edhe mos të jetë ashtu që dikush të amnistohet e dikush faktikisht të dënohet përsëri edhe nga ne.

Betim Gjoshi: Edhe kryetare është imediate që formulari i zyrës me ndryshuar se e kanë një gabim teknik atje sa i përket te neni 29.

Adnan Rrustemi: Megjithëse u vërejt në fjalën e secilit që ka emërues të përbashkët dhe dispozita është e pa drejt për kundër faktit që po themi që është, duhet ta zbatojmë. Fakti që po e konstatojmë të pa drejt, e para e punës është pak si me thënë thirrje dashakeqëse për zbatim të një dispozite të pa drejt që bie në kundërshtim edhe me nenin 45 të kushtetutës. Sido qoftë është çështje e interpretimit por ajo çka i mbetet për të ardhmen është jo domosdoshmërisht zbatimi por zbërthimi, interpretimi, ndryshimi marrja e vlerësimit të institucioneve përkatëse, sqarimi paraparak. Një kohë kur KQZ-ja e ka paraparakisht që me u siguruar që nuk merren vendime të tilla që mbase në 90% të rasteve janë të drejta në 10% të rasteve janë të pa drejta janë arbitrare edhe i merret dikujt e drejta e kandidimit. Edhe një rast tjetër sikurse në ndonjë rast tash për ta shfrytëzuar të drejtën civile dhe politike dhe të kandidimit në këtë rast tash për me shfrytëzuar të drejtën civile dhe politike të kandidimit në këtë rast, për tu zgjedhur.

Unë, tha z. Rrustemi, mendoj që ne e kemi pasur një mundësi si KQZ me dal si me thënë mbi situatat e kërkuara me bo vlerësimin e këtyre rasteve një për një, në përputhjet me dispozitat e kodit penal dhe të nenit sidomos 45 të kushtetutës që po e përsëris që thotë e drejta për të kandiduar mund ti hiqet vetëm me vendim gjyqësor kjo e drejt. Sikurse edhe neni tjera por të shpresojmë që të sqarohet, interpretohet mbase edhe ndonjë ankesë e vërteton por të paktën të mos konsiderohet një standard që duhet ndjekur le të konsiderohet një rast që kërkon zgjidhje për të ardhmen, zgjidhje të drejt në përputhje me standardet ndërkombëtare edhe me vendimet e gjykatës Strazburgut edhe me konventat ndërkombëtare po ashtu, faleminderit.

Betim Gjoshi: Kjo i bie se unë skam qejf askush fjalët e askujt mi keq interpretuar. Ligjet i ndryshon Kuvendi i Republikës së Kosovës, një pjesë e madhe e jona kanë qenë mbështetës të reformës zgjedhore, mirë është me mbështet. Ligji mbetet i njëjti, standardi është krijuar tashmë edhe e dyta na rolin e gjykatës nuk mundemi me marrë mi klasifikuar. Me këtë ligj, gjitha veprat penale që janë të gjykuara me ligj me gjykim të formës së prerë i ka trajtuar njëjtë, mua nuk po më pëlqen unë jam jurist jam penalist vet e di që dallon, qëllimi, dashja e shumë çështje të tjera por në ligj i kanë trajtuar. Ligjvënësi duhet me qenë më të përgjegjshëm se paguhen për këtë me pru ligje më të mira jo na, na e kemi për detyrë me i zbatuar. Na mundemi mi detektuar edhe me njoftuar kuvendin që në këtë pjesë ki probleme por nuk mundemi me ndryshuar ligjin as nuk mundemi me zbatuar në qoftë se ndonjë nen mendojmë që nuk është i drejt ka plot nene në këtë ligj që mendoj që nuk janë të drejta, faleminderit.

Valdetet Daka: Po urdhno Eshref.

Eshref Vishi: unë mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhor nuk ka pas transparence në komunikimi më subjektet politike, sa i përket zbatimit të kësaj dispozite ligjore. U tha edhe më herët dhe e dinë të gjithë se po zbatohet për herë të parë, po të komunikohet me subjektet politike në kuptimin që ata të kenë në vëmendje më të shtuar në mos përfshirjen e kandidatëve në precedent penal nuk do ta kishim këtë situatë këtu. Një barrë e përgjegjësi e fajit është edhe në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve në komunikim me partitë politike.

Valdete Daka: Faleminderit Eshref, me vjen keq po nuk e kamë ndërmend me polimizuar me asnjë prej anëtareve, mirëpo nuk mundem pa e përmend, kjo çështja e dënimeve është fol e është përfol një kohë të gjatë, dhe nuk është hera e parë që është botim, është e vërtet që për herë të parë po zbatohet nga ne d.m.th na e kemi kërkuar për verifikim sepse të gjithë kandidatët kur i nënshkruajnë formularët e kanë obligim edhe nënshkruajnë se nën përgjegjësin penale dhe morale të gjitha shënimet te cilat i japin janë të vërteta d.m.th dhe ju thuhet se i përmbahen nenit 29, ajo që është e vërtet që nuk shkruhet dispozita e nenit 29 mirëpo neni 29 përmendet, dhe kandidatët kishte qenë mirë të jenë ma të vëmendshëm ta lexojnë nenin 29 te ligjit mbi zgjedhjet dhe ta kenë parasysh se për çka po nënshkruhet sepse ata të gjithë e nënshkruajnë formularin dhe deklarohen se të gjitha shënimet që i kane dhanë janë të vërteta d.m.th nën përgjegjësin penale dhe morale të tyre.

Binak Vishi: Kryetare vetëm diçka desha të them për ato që po e përmend ti, dhe kujtoj se me subjektet politike është komunikuar në ditën e certifikimit të subjekteve politike të kandidatëve, ku është vënë në theks precedenti penal dhe kontrollimi i listave, jo edhe më herët, d.m.th., jemi vonë për këtë duhet ta pranojmë gabimin....

Valdete Daka: Faleminderit unë mendoj që e kemi shtjerr diskutimin. Atëherë unë qesë në votim se kush është për de certifikimin e të gjithë kandidatëve të cilët kanë akt gjykimin e formës së prerë te 3 vitet e fundit nga gjykata e Kosovës kush është për, faleminderit, kush është kundër, kush abstenon, d.m.th mundem me deklaruar që i kemi 8 vota për, 1 votë abstenim dhe 1 vote kundër, njëkohësisht ju informoj se kandidatët te cilët de certifikohen kanë të drejt që, që nga ky moment 24 ore nga ky moment të parashirojnë ankesë në PZAP, ndërsa subjektet politike nga të cilat vijnë këta kandidatë kanë të drejtë që deri më datë 15 shtatorë të bëjnë zëvendësimin e këtyre kandidatëve. Faleminderit.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
